



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME QARKU SHKODËR SH.A

Shkoder, me 08.10.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:
Fiskalizimi i faturave

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Sherbime fiskale 79220000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,322,500 (Nje milion e treqind e njezet e dy mije e peseqind)
leke pa TVSH .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor SHRUKQSH ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Specifikimet teknike jane hartuar nga pergjegjesi i IT Arsen Tafilica si me poshte:

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Sherbimi i Fiskalizimit te faturave tatimore elektronike, faturave pa para ne dore, faturave me para ne dore, faturave shoqeruese dhe veprimeve te arkave te Shoqerise Rajonale UK Shkoder Sh.a	copë	1

--	--	--	--

Specifikimet teknike:

1-Funksionalitetet që duhet të ketë programi:

1. Të rregjistrojë shpejt dhe lehtë dokumentacionin ku përfshihen faturat dhe arkëtimet.
2. Të jetë i integruar me sistemin e faturimit AI Billing të cilin institucioni e përdor aktualisht. Faturat për të gjithë abonentët të merren automatikisht nga sistemi i faturimit dhe të fiskalizohen.
3. Sistemi i fiskalizimit të dërgojë sistemit të faturimit të gjithë informacionin e nevojshëm mbi fiskalizimin e faturave.
4. Faturat për veprimet të cilat nuk përfshihen në sistemin e AI billing si psh lidhje të reja, ndryshim emri etj. të ketë mundësi të regjistrohen manualisht.
5. Të jetë i integruar me sistemin e AI billing për të marrë të gjithë informacionin e nevojshëm për arkëtimet e faturave.
6. Të gjenerojë raporte dhe informacion mbi faturat të cilat janë fiskalizuar ose jo.
7. Të përfshijë mirëmbajtjen e sistemit të fiskalizimit për 12 muaj.

Sipas vendimit nr:239 dt. 20/03/2020 bazuar në

LIGJIN Nr. 87/2019 PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT1 ;

1. Operatori Ekonomik duhet të ketë zgjidhjen e certifikuar të software-it në formën e një aplikacioni individual, ose një sistemi kompjuterik të integruar, ose një aplikacion Cloud, i cili mundëson:

- a) krijimin e një fature, një fature shoqëruese dhe vendosjen e të gjithë elementeve të nevojshëm;
- b) vlefshmërinë e operatorit që lëshon faturën ose faturën shoqëruese;
- c) dërgimin e sigurt të të dhënave në sistemin qendror, duke përdorur certifikatën elektronike;
- ç) lëshimin dhe pranimin e faturave elektronike;
- d) transmetimin automatik të të dhënave në administratën tatimore dhe marrjen e mesazhit konfirmues nga administrata tatimore, pas verifikimit automatik të secilës faturë individuale ose fature shoqëruese;
- dh) ruajtjen e të dhënave të faturave ose të faturave shoqëruese;
- e) gjenerimin e numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF) dhe numrit të sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese (NSLFSH);
- ë) gjenerimin e kodit QR;

f) printimin e faturës ose thjesht kodit QR, në situata të përcaktuara në ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”;

g) sigurojnë shkëmbimin e të dhënave në kohë reale dhe me autentifikim të sigurt të pajisjeve fiskale ekzistuese ose sistemit të fiskalizimit;

sipas **LIGJ Nr. 2/2017 PËR SIGURINË KIBERNETIKE1** Funkcionalitetet të tjera që duhet të ketë programi:

2. Bazat e të dhënave, të jenë të pa-aksesueshme jashtë këtij sistemi
3. Hyrja në program të sigurohet me kredenciale “përdorues” dhe “Fjalëkalim”.
4. Të ofrojë një mekanizëm për administrimin e privilegjeve në mënyrë të detajuar për funksionalitete të ndryshme. Në këtë mënyrë çdo përdorues ka akses vetëm tek ambientet, modulet apo raportet që i janë përcaktuar më parë nga një përdorues administrator.
5. Të ofroje mundësinë për të përcaktuar autorizime të detajuara se cili përdorues apo rol të mund të shikojë, administrojë llogari apo element ose ambiente të caktuara.
6. Të ofroje mundësinë që një përdorues i caktuar të mund të shikojë vetëm veprimet e tij dhe jo veprimet e të tjerëve.
7. Të mundesojë regjistrimin e çdo krijimi, anulimi apo modifikimi dokumenti nga ana e përdoruesve.
8. Të mundesoje regjistrimin e datës,orës, përdoruesit dhe të IP-së së atij që ka kryer veprimin gjatë regjistrimit të auditimit.
9. Të mundesoje historikun e veprimeve, pra të mund të shihen dokumentet si kanë qenë para modifikimit.
10. Backup

Të dhënat të ruhen çdo ditë nëpërmjet një procesi automatik backup.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është bazuar në Ligjin 162 datë 23. 12 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetë-deklarimit”, dhe në VKM-në nr. 285 datë 19. 05. 2021 i ndryshuar, “Për Miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”. Me anë të këtij kriteri AK kërkon të jetë i siguar për gjendjen aktuale të OE, për përmbushjen me sukses të kësaj kontrate.

b. Formularin e Ofertës sipas Shtojcës 1;

c. Listën e Çmimeve sipas Shtojcës 2.

Argumentimi: Kriteret e mësipërm (b, c) janë bazuar në VKM-në nr. 285 datë 19. 05. 2021 i ndryshuar, “Për Miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 15, “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit”, pika 2.

ç. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është bazuar në Ligjin 162 datë 23. 12 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, dhe në VKM-në nr. 285 datë 19. 05. 2021 i ndryshuar, “Për Miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 30 “Sigurimi i ofertës”.

Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit).

Të jetë qartësisht e specifikuar në QKB, se objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik është i njëjtë ose “ekuivalent” me objektin e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 162 datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;” dhe pika 2: “Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë...”, si dhe në VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”.

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2022,2023, me nje vlere jo me te ulet se 40% e fondit limit te ketij prokurimi. **Kjo Kërkese konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.**

2.1.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancin vjetor, për vitin financiar 2022, 2023 shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në përputhje me Ligjin Nr. 162 datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3: “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të jetë e madhe se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës...” bazuar në nenin 43 të VKM-në Nr. 285 datë: 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore kërkohet bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30. 01. 2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

Bilancet për dy vitet e fundit janë kërkuara bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe shërbimit për të njohur gjendjen financiare të operatoreve ekonomik ofertues

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme me një vlerë prej 20% të fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të

plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vërtetuar eksperiencën e operatoreve ekonomik ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontratës me sukses

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka stafin e nevojshëm teknik të kualifikuar. Pjesë e stafit të Operatorit Ekonomik duhet të jenë të paktën:

- 1 (një) punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje infrastrukture;
- 1 (një) punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje network-u;
- 1 (një) punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje aplikacioni web/mobile.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin kontratat e punës, certifikatat përkatëse si dhe listëpagesat e muajit Shtator 2024

Argumentimi

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm referuar zërave të preventivit të objektit për realizimin e kontratës në mbështetje të pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje të Nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6, germa (c) ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...” Gjithashtu, bazuar në ligjin nr. Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” ku parashikohet se pagesat e kontributeve bëhen:

“Nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës, kemi percaktuar listepagesat e mujit Shtator 2023.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autorët e programit kompjuterik "Al-Billing", sistemi i faturimit në përdorim dhe rregjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA per kategorinë e veprës “Programe Kompjuterike”, Neni 7/A, ose ekuivalente. **Gjithashtu mund** të paraqesin Autorizim të lëshuar nga autorët e programit kompjuterik, që kanë të drejtën të ofrojnë shërbimin për "Programin kompjuterik AL Billing".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Aktualisht Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sh.a. përdor sistemin e faturimit ”Al-Billing” me të drejtë autori dhe bazuar në Ligjin Nr. 35/2016 "Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të Lidhura me to". Për të garantuar kalimin me sukses të të dhënave dhe punës me sistemin e Faturimit Al-Billing sipas kërkesave të AK, duhet që operatori ekonomik të paraqesë dokumenta që bindin se ka të drejtë të punojë me sistemin aktuale dhe mund ta zbatojë këtë kontratë sipas pritshmërive të AK ndaj kërkohet e drejta e autorit.

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën e cilësive ISO 9001:2015, për sistemet e menaxhimit të cilësive ose ekuivalente, të lëshuar nga kompani të cilat njihen nga institucionet zyrtare Shqiptare dhe që janë të akredituara (të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi për të garantuar shërbimin në mënyrë të vazhdueshme me cilësi sipas specifikimeve teknike duhet që operatorët ekonomik ofertues të jenë të certifikuar për cilësinë e shërbimeve që ofrojnë sipas standarteve ndërkombetare.

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën e cilësive ISO 27001:2013 mbi Sistemet menaxhimit të sigurisë së informacionit ose ekuivalente, të lëshuar nga kompani të cilat njihen nga institucionet zyrtare Shqiptare dhe që janë të akredituara (të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar). Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi për të garantuar sigurinë e informacioneve gjatë kryerjes së shërbimeve duhet që operatorët ekonomik ofertues të jenë të certifikuar për cilësinë e shërbimeve që ofrojnë sipas standarteve ndërkombetare.

Njesia e Prokurimit